



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Ilir META



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE (AMA) PËR VITIN 2015

**Kuvendi i Shqipërisë:**

- Duke konsideruar të rëndësishëm respektimin e parimeve themelore, gjatë zhvillimit të veprimtarisë audiovizuale, në drejtim të garantimit të lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe të së drejtës për informim, si të drejta që burojnë nga Kushtetuta dhe legjislacioni i posaçëm;

- Duke besuar se shërbimet audiovizuale shqiptare duhet të reflektojnë vlerat dhe identitetin e shoqërisë shqiptare, zhvillimit në pavarësi të plotë dhe efikasitet cilësor editoriale, në përmbushje të ligjit për mediat audiovizive, si dhe zhvillimit të teknologjive të reja, sipas standardeve europiane, duke përmbushur detyrimet ndërkombëtare për procesin e digjitalizimit;

- Duke ritheksuar se bordi rregullator i AMA-s ka një rol të rëndësishëm në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe duhet të garantojë përgjegjshmëri, integritet, pavarësi, paanshmëri dhe efikasitet për të kryer pa pengesa dhe vonesa të mëtejshme të gjitha funksionet e ngarkuara sipas ligjit;

Kuvendi i Shqipërisë, duke u angazhuar si organ ligjvënës, por dhe monitorues i zbatimit të ligjit për mediat, shpreh qëndrimin e tij për mbështetjen e vazhdueshme të institucionit të AMA-s në implementimin e ligjit dhe arritjen e objektivave të tij institucionale.

**Kuvendi i Shqipërisë vëren se:**

1. Veprimtaria e AMA-s, gjatë vitit 2015, ashtu si dhe gjatë vitit 2014, ka hasur pengesa në raport me përfaqësimin e anëtarëve të Bordit të AMA-s në vendimmarrje, si pasojë e të cilit janë shkaktuar këto ndërime institucionale me rezultate negative në:

- pamundësi në vendimmarrje, ku kërkohet shumicë e cilësuar, si rinovimi i licencave dhe/ose autorizimeve e përkthyer në të ardhura vjetore të munguara, të cilat kanë ndikuar në burimet financiare të institucionit dhe në vendosjen e prioriteteve për menaxhimin e tyre; AMA ka vështirësi financiare në mbulimin e investimeve të kërkuara në përmirësim të kapaciteteve;

- pamundësi për heqjen e licencave dhe/ose autorizimeve, duke rritur numrin e subjekteve në mospërbushje të detyrimeve financiare përtej afateve ligjore;

- mosrespektim të afateve të strategjive kombëtare, duke pamundësuar realizimin e proceseve, ku kërkohet funksionimi i plotë i AMA-s, referuar kryesisht procesit të digjitalizimit, afati i të cilit ishte data 17 qershor 2015;

- pamundësi në dhënien e licencave, e shoqëruar kjo me kosto të larta financiare për Autoritetin, si dhe një ndër shkaqet kryesore që kanë çuar në pamundësinë e Autoritetit për zhbllokimin e procesit të licencimit të rrjeteve numerike private kombëtare, i cili do të mundësonte rregullimin e tregut audioviziv dhe përshejtimin e procesit të digjitalizimit;

- mosrekrutimi i Këshillit të Ankesave, tashmë i përcaktuar si njësi në strukturën organizative të Autoritetit, në përmbushje të kërkesave ligjore.

2. Nga rezultatet e kësaj performance, rezulton, gjithashtu, se AMA nuk ka mundur të zbatojë një pjesë të kërkesave të rezolutës së Kuvendit që i kishte vendosur si rekomandime të zbatueshme për vitin 2015.

3. Vetë Kuvendi, përmes proceseve të vonuara në Komisionin përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, ka vonuar plotësimin në kohë të bordit me anëtarë të rinj, duke ndikuar në krijimin e hapësirës dhe mundësisë për shkeljen e detyrimeve ligjore nga disa anëtarë me mandate të përfunduara, për të mos përmbushur shumë procese të rëndësishme të kësaj të fundit.

4. Këta tregues janë paraqitur me shqetësim dhe raportuar në vijimësi nga vetë AMA edhe pranë Komisionit Europian, i cili, përmes dokumenteve të shumta të tij, si progresraportet 2014 dhe 2015 dhe raportimeve në nënkomitetet sektoriale për politikën audiovizuale, nxitin autoritetin rregullator të forcojë pavarësinë e tij institucionale, duke ushtruar funksionet e plota të tij vendimmarrëse dhe operacionale dhe përmyllur procesin e digjitalizimit.

### **Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se:**

Pavarësisht këtyre treguesve negativë, AMA, në tërësinë e tij si institucion, ka arritur të plotësojë disa rekomandime të tjera të Kuvendit të Shqipërisë në përpjekjet e saj për përmirësimin e qeverisjes së rregullatorit në rritje të pavarësisë së Autoritetit, duke përqendruar fokusin në përmirësimin e kuadrit institucional, vendimmarrjes dhe zbatueshmërisë së kësaj vendimmarrjeje, në përfrim të plotë me direktivat europiane, të tilla si:

1. Plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore të nevojshme për zhvillimin e procesit të digjitalizimit, si dhe ka vijuar punën me procesin e këshillimit publik;

2. Përmirësimin e shfrytëzimit të burimeve të financimit, duke dyfishuar normën e arkëtueshmërisë së të ardhurave financiare për vitin 2015, krahasuar me normën mesatare të viteve të fundit, edhe pse vazhdon të ketë probleme financiare të mbartura në vite;

3. Përmirësimin e dukshëm në llogaridhënien dhe transparencën, me miratimin e programit të transparencës në rregullimin e procesit të konsultimit publik, publikimin e informacionit mbi masat e marra dhe kërkesat rregullatore ndaj OSHMA-ve, si dhe llogaridhënien financiare të pasqyrave kontabël të tyre, duke rritur dukshëm imazhin institucional të Autoritetit;

4. Përqasjen e re të veprimit të AMA-s ndaj fenomenit të piraterisë, duke krijuar linja komunikimi të drejtpërdrejta dhe transparente me subjektet, si dhe është përmirësuar efikasiteti i masave të marra dhe sanksioneve të vëna ndaj subjekteve në shkelje për ndalimin e fenomenit të piraterisë;

5. AMA ka kryer koordinim të vazhdueshëm me RTSH-në për procesin e digjitalizimit të rrjeteve të RTSH-së, duke e konsideruar si çelësin kyç të digjitalizimit operatorin publik jo vetëm për kanalet e veta, por dhe për operatorët rajonalë dhe lokalë;



6. AMA ka vepruar si nxitës i rritjes së shumëllojshmërisë së shërbimeve, duke ndërmarrë implementimin e një plani veprimi për zhvillimin e sistemeve kablore në Shqipëri, si dhe nxitjen e subjekteve të reja, që aplikojnë për të ofruar transmetime audiovizive mbështetur në sistemet kablore, që ofrojnë shërbimet në teknologjinë digjitale.

### **Kuvendi nxit dhe kërkon nga AMA për vitin 2016:**

1. Zbatimin me përpikëri të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke përbushur të gjitha objektivat dhe detyrimet që burojnë prej tij, me qëllim rritjen e impaktit të ligjit dhe performancës institucionale të AMA-s.

2. Angazhimin e Autoritetit në përmbylljen e plotë të të gjitha hallkave të parashikuara në procesin e digjitalizimit dhe finalizimin e këtij procesi të kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.

3. Rritjen e zbatueshmërisë ligjore, duke konsideruar rolin e Autoritetit si në dizejnimin e politikave të duhura, ashtu edhe për ekzekutimin e tyre, si mekanizmi kryesor i ndërveprimit midis ofruesve të shërbimeve audiovizive, publikut, organeve shtetërore dhe aktorëve të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ku, ndër të tjera:

- hartimin e akteve rregullatore, marrëveshjeve, dokumenteve të tjera për sigurimin e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së lartë të programeve dhe me risi nga OSHMA-të publike e private, si dhe promovimin e programeve të shumëllojshme dhe pa pagesë;

- hartimin e politikave që bëjnë të mundur sigurimin e përbushjes së objektivave nga transmetuesit e shërbimit publik, sipas përcaktimeve ligjore dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës së shërbimit të lidhur me RTSH-në; koordinim me RTSH-në, lidhur me procesin e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike dhe mbikëqyrjen për ndërtimin e rrjeteve numerike të RTSH-së.

4. Përmirësimin e rolit rregullator të Autoritetit në mbikëqyrjen e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave, si në drejtim të konstatimit të shkeljeve dhe në marrjen e masave administrative për të gjithë subjektet audio/audiovizive që nuk zbatojnë ligjin, aktet rregullatore apo kushtet e përcaktuara në licencë.

5. Vijimin e monitorimit ndaj fenomenit të piraterisë dhe ndërgjegjësimit publik për respektimin e të drejtave të transmetimit/autorit, si pjesë e pronësisë intelektuale.

6. Angazhimin e Autoritetit në përmirësimin e planit financiar dhe sigurimit të burimeve të tjera të financimit, duke u mbështetur edhe në ndërveprimin e organeve të tjera hartuese dhe miratuese të Buxhetit të Shtetit, për mbulimin e fondeve të pamjaftueshme për shpenzimet me natyrë të veçantë, për të cilat nuk ekziston mundësi tjetër financimi.

7. Funksionimin e plotë të Këshillit të AMA-s për mbarëvajtjen e proceseve dhe organeve ndihmëse të tij, si dhe miratimin e akteve të brendshme, si kërkesë e ligjit, të kodit të tij të sjelljes (etikës), ku të rregullohet dhe konflikti i interesit, si dhe miratimit të rregullores së brendshme për funksionimin e këtij bordi, gjatë ushtrimit të detyrës dhe funksioneve që i njeh ligji.

Miratuar në datën 14.4.2016